

Intervistë me Ambasadorin Pavel Vacek, në prag të largimit, 1 tetor 2007

Gazeta “Panorama”

Z. Vacek ju jeni në përfundim të mandatit tuaj në Shqipëri. Me çfarë përshtypjesh jeni duke u larguar dhe cili do të ishte mesazhi që do t’i linit opozitës dhe qeverisë?

Shumicën e kohës kam preferuar të punoj në mënyrë të drejtpërdrejtë me partnerët përkatës dhe nuk më është dukur e nevojshme të dërgoj ndonjë mesazh madhështor... Nevoja për të dhënë mesazhe publike është shpesh tregues i një problemi. Megjithatë, ajo që mbetet për t’u dëshiruar është që, si koalicioni qeverisës dhe opozita, të provojnë se ata besojnë vërtet në ato që thonë duke vënë në jetë gjithë premtimet e tyre. Ata kanë gjithmonë nevojë për komunikim konstruktiv dhe disa herë edhe për bashkëpunim, për të realizuar reformat e rëndësishme kombëtare... Sinjale inkurajuese janë duke ardhur për lëvizje në këtë drejtim ...

Si Kreu i Prezencës së OSBE-së, ju keni monitoruar nga afër proceset zgjedhore në Shqipëri. Çfarë progresi është arritur nga njëra zgjedhje në tjetrën?

Ka pasur raporte të hollësishme nga të tjerët për këtë ... por si mund ta përshkruaj progresin me një fjalë? Në rritje...

Pse duhet të ndryshojë kodi zgjedhor pas çdo zgjedhjeje, qofshin ato vendore apo lokale?

Në fakt...nuk ka shumë rëndësi se çfarë klisheje përdoret për të përshkruar zgjedhje cilësore – qoftë “të lira dhe të ndershme” apo “në përputhje me standardet ndërkombëtare”. Megjithatë cilësia e pranueshme për të cilën po flasim, sigurohet më pak nga përsosmëria dhe detajet e ligjit në vetvete, dhe shumë më tepër nga zbatimi i tij dhe praktikatat e mira. Ndryshimet në kuadrin zgjedhor shqiptar janë udhëhequr nga dëshira për të adresuar të metat dhe praktikatat e këqija të aspektit zbatues, duke përsosur më tej ose duke ndryshuar ligjin, por pa përmirësuar në mënyrë thelbësore zbatimin në vetvete, përfshirë këtu qëndrimet dhe praktikatat e njohura ...

Jo rrallë jeni sulmuar nga politika Shqiptare. Kujtojmë deklaratat e Z. Ceka i cili dikur i ka bërë thirrje OSBE-së të largohet nga vendi. Si i keni përjetuar deklaratat të tilla? A keni pasur momente të vështira gjatë qëndrimit tuaj dhe si i keni kaluar ato?

Sigurisht, Prezenca nuk ka për të ndenjur përgjithmonë. Gjetkë në rajonin e Evropës Juglindore reduktimi ka progresuar më tepër. Megjithatë këto gjëra nuk ndodhin si reagim ndaj figurave të parëndësishme, por mbi baza analizash dhe konsultimesh. Dhe për sa u përket momenteve të vështira? Nuk jam i sigurt nëse kanë qenë më shumë momente të vështira sesa momente shpërblyese, nuk i kam numëruar... Megjithatë disa nga momentet më të vështira kanë qenë ato kur këshillat apo ofertat tona për bashkëpunim nuk janë

marrë parasysh nga autoritetet Shqiptare, pa dhënë ndonjë shpjegim racional apo pa pasur të vlefshme një alternativë funksionale.

Profili juaj gjatë këtyre viteve ndryshoi shumë krahasuar me paraardhësin tuaj. Ishit më pak prezent në publik me mesazhe dhe deklarata. A ka qenë kjo një zgjedhje e juaj apo pak nga pak roli i OSBE-së po zvogëlohet? Si e shihni të ardhmen e OSBE-së në Shqipëri?

Nuk më është dukur se puna jonë do të kishte ndonjë përfitim nga ndërtimi i një “profili mediatik” të lartë ... Në vend të kësaj unë jam përpjekur të bëj ç’është e mundur për të përmirësuar ndërveprimin me partnerët vendas dhe për të rritur volumin e fondeve në dispozicion të punës për kryerjen e detyrave që na ngarkon mandati. Prezenca e Organizatës do të vazhdojë të zvogëlohet dhe përfundimisht edhe do të largohet... Nëse kjo do të bëhet sipas kalendarit pesë-vjeçar të kërkuar nga qeveria apo ndryshe, kjo është çështje tjetër. Politikanë të përgjegjshëm, qoftë nga e djathta, qoftë nga e majta, e dinë se çfarë është realiste dhe e kuptojnë se largimi do të varet nga progresi i reformave në vend.

OSBE-ja është e përfshirë në një projekt shumë ambicioz, i cili është kompjuterizimi i Gjendjes Civile. Sa do të ndihmojë ky projekt në pajisjen e qytetarëve me karta identiteti dhe si rezultat në zhvillimin e zgjedhjeve të ndershme?

Asistenca e OSBE-së për modernizimin e gjendjes civile dhe sistemin e adresave, financuar nga Komisioni Evropian ka për qëllim të ndihmojë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë sigurimin e kartave të reja të identitetit për shqiptarët, pasi Gjendja Civile është PIKËRISHT baza e të dhënave nga e cila duhet të nxirren të dhënat për lëshimin e kartave të identitetit. Në qoftë se kartat e reja të identitetit dhe pasaportat kërkohen të bëhen paralelisht, në mënyrë të shkëputur nga modernizimi i Gjendjes Civile, nuk mendoj që kjo është e dëshirueshme, por nëse ndodh kështu minimumi i nevojshëm është që të sigurohet një verifikim i besueshëm i të dhënave të mbledhura nga shtetasit që bëjnë kërkesë për dokumente të reja, me të dhënat në regjistrat e gjendjes civile. Shpresoj se tashmë gjithkush e kupton këtë ndërvarësi të të dyja përpjekjeve si dhe risqet dhe kostot, përfshirë edhe ato në nivel ndërkombëtar, në qoftë se kjo gjë nuk bëhet siç duhet ...

Si e vlerësoni situatën politike në Shqipëri? Nga përvoja juaj si Ambasador, cili mendoni është “çelësi i artë” që do të sillte një klimë të re politike dhe përfundimisht zgjedhje të pakontestuar nga palët?

Ju duhet ta dini më mirë se unë këtë gjë... por ajo që mund të sjellë një ndryshim vendimtar të klimës është presioni mbi aktorët politikë ushtruar nga qytetarët dhe komuniteti i biznesit, si dhe presioni që vjen prej nevojës që politikanët duhet të mbajnë premtimet e bëra. Për të dhënë rezultate në reforma të rëndësishme kërkohet një ndryshim në qëndrim... Kjo përfshin reformën zgjedhore dhe zgjedhjet: problemi me të gjitha ndryshimet ligjore dhe skemat ka qenë se protagonistët, si të majtë dhe të djathtë, kanë kërkuar një lloj epërsie, avantazhi mbi kundërshtarët dhe janë përpjekur ta bëjnë këtë

duke dredhuar ndaj hileve, qofshin reale apo të perceptuara të palës tjetër – kjo ka ndodhur të paktën deri së fundmi. Prandaj ka qenë gjithmonë e vështirë të kuptosh nëse ajo që thonë është ajo që vërtet nënkuptojnë...

Cilët nga politikanët do të vlerësoni më shumë gjatë këtyre tri viteve të punës, për bashkëpunimin e ofruar kryesisht për çështje të reformës zgjedhore?

Që të përmend një, p.sh., besoj se ish-Presidenti Moisiu kërkonte të vendoste ekuilibër dhe paanësi dhe meritonte më shumë mbështetje në vend... Përveç kësaj unë e kam vlerësuar gjithmonë kohën dhe vëmendjen që më kanë kushtuar të gjithë përfaqësuesit, të zgjedhur apo të emëruar, politikanë apo profesionistë, të djathtë apo të majtë... Kjo gjë e ka bërë punën shpërblyese...